



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS
01Nr. 104/02-25329 /23
Kaçanik, 15.09.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Ligjit Nr.06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunëses civile, znj. Arbnora Kuka, Zyrtare e lartë për shëndetësi në kuadër të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale i caktohen detyra shtesë jashtë funksionit të caktuar të saj, përkatësisht ngarkohet edhe me detyrat e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave personale .
2. Punët dhe detyrat si Zyrtare për mbrojtjen e të dhënave personale do ti kryejë përkohësisht, deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Bazuar në Ligjin Nr.06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), si mbikëqyrës i zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim të mbështetjes për përmbushjen e obligimeve ligjore ka kërkuar që të caktohet me vendim Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale.

Prandaj, duke u mbështetur në kërkesën e cekur më lartë dhe për të përmbushur obligimet ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr.06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale është konstatuar që të caktohet përkohësisht një zyrtar që do të kryejë këtë pozitë.

Andaj, duke pasur parasysh këto që i theksuam më lartë, përgatitjen profesionale të zyrtares, u konstatua se zyrtarja në fjalë krahas kryerjes së detyrave në vendin e saj të punës, mund t'i kryej edhe detyrat në pozitën Zyrtar për mbrojtjen të dhënave personale.

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohen;

- znj. Arbnora Kuka
- Zyra e personelit

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi



| | | |
|--|--------------|----------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK | | |
| Data: 22.09.2023 | | Vendi: KAÇANIK |
| Nj. orig. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 104/02-25064 | / |

Bazuar në nenet 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoatin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapisinor dhe Ndërtimit, Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet, si dhe Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E
ANKESËS 01 Nr. 104/02-24672

- I. Me këtë vendim formohet Komisioni i përkohshëm për shqyrtimin e ankesës 01 Nr. 104/02-24676/23 të dt. 19.09.2023 nga "2 Korriku" sh. p. k Soponicë - Kaçanik, me drejtor z. Ejup Kovaqin.
- II. Komisioni do të jetë me këtë përbërje:
 1. Fadil Guri - kryesues;
 2. Gentiana Kastrati - anëtare, dhe
 3. Kaltrina Guri - anëtar.
- III. Komisioni ka për detyrë të pranoj, shqyrtoj dhe të vendos për ankesën e "2 Korriku" sh. p. k me pronar z. Ejup Kovaqi, të ushtruar ndaj zyrës së kryetarit - Sektorit të Inspektoratit, konkretisht ankesës ndaj aktvendimit 104/02-24293, të dt. 19.09.2023.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
- V. Me nga një kopje të këtij vendimi, njoftohen: Anëtarët e Komisionit dhe Arkiva.

Kaçanik, 22.09.2023

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



| | | | | |
|---|----------|----------|---------|--------------|
| 1 | Data | 26.09.23 | Vendi | KAÇANIK |
| | Nj. org. | 01 | Numri | 104/02-25360 |
| | | | Shtojcë | |

Data: 26.09.2023

Republika e Kosovës, Komuna e Kaçanikut, në bazë të neni 13 dhe 14.1 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, neni 5, neni 7 dhe neni 9 pika 3 dhe 8 të rregullores MF - nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR DHURIMIN E PASURISË JO FINANCIARE PËR KRM "PASTËRTIA"

I. I dhurohen KRM "PASTËRTIA", 5 (pesë) tavolina pune, 1 (një) tavolinë mesi, 1 (një) kaset lëvizëse dhe 7 (shtatë) karrike statike për zhvillimin e aktiviteteve të kësaj kompanie, në bazë të kërkesës të paraqitur nga kjo kompani dhe në bazë të rekomandimeve të datës 03.07.2023 ; 21.08.2023 dhe 07.09.2023 të komisionit për vlerësimin e pasurisë jofinanciare 01-Nr.104/02-10854/23, si dhe duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret e lartshënuara Zyrtari Kryesor Administrativ vendos si vijon:

II. Inventari i përbërë: 5 (pesë) tavolina pune, 1 (një) tavolinë mesi, 1 (një) kaset lëvizëse dhe 7 (shtatë) karrike statike, i dhurohet KRM "Pastërtia".

III. Inventari i dhuruar largohet nga përgjegjësia e komunës, si dhe nga sistemi i e-pasurisë dhe kjo e fundit nuk ka asnjë obligim në mirëmbajtjen e tyre.

Arsyetim

Inventari i dhuruar i plotëson nevojat elementare, dhe si i tillë është parë e arsyeshme të i dhurohet KRM "PASTËRTIA".

Sipas kërkesës, është vlerësuar që kjo pjesë e inventarit ju shërben sadopak të zvogëlojnë vështirësitë që kanë punëtorët e kësaj kompanie në zhvillimin e aktiviteteve të punës.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Drejtorja e Financave,
2. Drejtorja e Administrates,
3. Parashtruesi i kërkesës,
4. Arkivi.

Kryetari i komunës:
Besim Ilazi

